



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

---

Numri i lëndës: 2020:155600  
Datë: 19.04.2024  
Numri i dokumentit: 05596609

C.nr. 827/20

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florid Hasku, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K., Sh.a. (K.), Distrikti në Gjakovë, kundër të paditurës D.G., nga Gjakova, Rr..., pa numër, tani me adresë të panjohur, me objekt kontesti kompensimin e dëmit material, jashtë seance, me datë 19.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET E TËRHEQUR padia e paditësit K.. (K...), Distrikti në Gjakovë, kundër të paditurës D.G., nga Gjakova, në çështjen juridike kontestimore për kompensimin e dëmit material, e evidentuar me numër të lëndës C.nr. 827/20.

A r s y e t i m

Paditësi K. SH.A. (K.), Distrikti në Gjakovë, pranë kësaj gjykate me datë 11.11.2020, ka parashtruar padi ndaj të paditurës D.G., nga Gjakova, Rr. .., pa numër, tani me adresë të panjohur, për kompensimin e dëmit material.

Gjykata me datë 20.02.2024 ka caktuar seancë përgatitore, me ç'rast në bazë të fletë kthesës ka konstatuar se e paditura është shpërngulur nga adresa e dhënë në padi, andaj gjykata në këtë seancë me aktvendimin C.nr.827/20, të datës 20.02.2024, e ka detyruar paditësin që brenda afatit prej 3 ditëve të plotësojë padinë me adresën e saktë dhe të plotë për të paditurën. Duke vepruar sipas këtij aktvendimi, paditësi me parashtrësën e datës 21.02.2024, e ka njoftuar Gjykatën me adresën e të paditurës.

Në adresën e dhënë Gjykata ka tentuar të komunikojë me palën e paditur, mirëpo nga fletë kthesa ka rezultuar se adresa është e panjohur. Në seancën e datës 20.03.2024, me aktvendimin e kësaj gjykate C.nr. 827/20, të datës 20.03.2024, është ftuar paditësi, që brenda afatit prej 15 ditëve të deponoj në arkën e kësaj gjykate shumën prej 500.00 € në emër të paradhënies për shpenzimet e caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm, me vërejtje të pasojave ligjore. Mirëpo paditësi nuk e ka bërë deponimin e shumës të caktuar për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm.

Me nenin 99.2 të LPK-së, është paraparë se “*parashtresat duhet të jenë të kuptueshme dhe të përmbajnë çdo gjë që nevojitet dhe e mundëson veprimin e tyre*”. Me nenin 102.1 të LPK-së, është rregulluar situata se si vepron gjykata kur një parashtresë nuk arrin të jetë e kuptueshme dhe e plotë siç kërkohet me nenin 99.2 të LPK-së, ndërsa me nenin 102.3, të po të njëjtit ligj, janë paraparë pasojat ligjore të mosveprimit, gjegjësisht veprimit të gabuar të palës.

Duke marrë parasysh faktin se edhe pas aktvendimit të lartpërmendur, paditësi brenda afatit të kërkuar nuk ka vepruar në përputhje me urdhrin e gjykatës, duke mos i dhënë shkas gjykatës që të veprojë sipas padisë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 102.3 dhe 142 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr. 827/20, me datë 19.04.2024

Gj y q t a r i  
Florid Hasku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimi të aktvendimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.